

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7141
E enjte, 14 mars 2024
Çmimi 0.50 €

Çfarë ka në 24 hektarët përreth Manastirit të Deçanit?



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTI 'LËSHON BAJRAKUN', URDHËRON KALIMIN E PRONAVE MANASTIRIT TË DEÇANIT.



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka lëshuar të mërkurën 'bajrakun' në lidhje me pronat për Manastirin e Deçanit. Ai ka thënë të mërkurën se qeveria e tij i ka kërkuar Agjencisë Kadastrale të Kosovës ta zbatojë vendimin e Gjykatës

Kushtetuese të Kosovës të vitit 2016 për tokën e Manastirit të Deçanit. Kurti ka thënë se ndonëse Qeverisë së Kosovës nuk i pëlqen vendimi, të cilin e ka cilësuar "të çuditshëm" e "të padrejtë", ajo nuk ka mjete ligjore dhe juridike për ta anuluar

vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ky vendim i Kurtit ka nxitur reagime të shumta në vend, pasi që përgjatë gjithë së kaluarës së tij politike, Kurti dhe partia që udhëheq kanë qenë kundër zbatimit të një vendimi të tillë

ESCOBARI NË PRISHTINË: KOSOVA DHE SERBIA T'I ZBATOJNË MARRËVESHJET



QEVERIA I HAP RRUGË BLERJES SË OBJEKTEVE PËR NEVOJAT E MISIONEVE DIPLOMATIKE TË KOSOVËS NË PARIS, ROMË, OTAVË DHE ANKARA



HAPET APLIKIMI PËR SUBVENCIONE NË BUJQËSI

ATK-ja DHE INSPEKTORATI I PUNËS INICIOJNË PROCEDURAT PËR GJOBITJEN E PUNËDHËNËSVE QË NUK I KANË DEKLARUAR PUNËTORËT

SPORT



PRETENDENTËT PËR TITULL MPOSHTEN NGA FUSHË-KOSOVA DHE MALISHEVA

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni dhe Trumpi sigurojnë nominimet partiake për zgjedhjet presidenciale të nëntorit

UASHINGTON, 13 MARS - Presidenti amerikan Joe Biden dhe ish-presidenti Donald Trump u zgjodhën kandidatë për president nga partitë e tyre përkatëse të mërkurën, pasi shënuan fitore vendimtare në zgjedhjet paraprake, duke e hapur rrugën për përsëritjen e një përballjeje ndërmjet tyre në zgjedhjet e nëntorit.

Rezultati i garave paraprake të martën në shtetet si Xhorxhia, Misisipi dhe Uashington nuk ka qenë asnjëherë në dyshim. As demokracia Biden, as republikani Trump, nuk u përballën me kundërshtarë të fortë.

Fitoret në zgjedhjet paraprake ua mundësojnë atyre numrin e mjaftueshëm të delegatëve të nevojshëm për t'u zgjedhur zyrtarisht kandidatë për president në konventat nacionale në verë.

Tani nuk ka më dyshim se në zgjedhjet e nëntorit Bideni dhe Trumpi do të përballen përsëri. Përsëritja e përballjes ndërmjet tyre - e para mes dy presidentëve amerikanë prej vitit 1912 - mund t'i thellojë ndarjet politike dhe

kulturore gjatë tetë muajve të ardhshëm, raporton "Associated Press".

Bideni e festoi nominimin nëpërmjet një komunikate, në të cilën e cilësoi Trumpin kërcënim serioz për demokracinë.

Trumpi, tha Bideni, është "duke e udhëhequr një fushatë shpagimi, hakmarrjeje dhe inati, e cila e kërcënon Amerikën".

Ndërsa Trumpi, në një video të postuar në rrjetet sociale, e festoi atë që e quajti "një fitore të madhe". "Por, tani, ne duhet t'i kthehemi punës, sepse e kemi presidentin më të keq në histori të vendit tonë", tha Trumpi për Bidenin. "Nuk do të humbim kohë për të festuar. Do të festojmë pas tetë muajve, pasi të kenë përfunduar zgjedhjet", shtoi ai.

As Trumpi e as Bideni nuk e kanë të lehtë rrugën përpara. Bideni, 81 vjeç, është tashmë presidenti më i vjetër në historinë e Shteteve të Bashkuara. Ndërsa Trumpi, 77 vjeç, përballlet me katër raste penale, përfshirë për tentimin për ta përmbysur rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2020 të cilat i humbi, si dhe për keqmenaxhim



të dokumenteve të klasifikuara.

Ai përballlet edhe me pyetje rreth planeve politike dhe marrëdhënieve me disa prej diktatorëve më të rrezikshëm në botë. Trumpi u takua privatisht të premten me kryeministrin e Hungarisë, Viktor Orban, i cili ka përmbysur demokracinë në

vendin e vet.

Bideni, i cili do t'i mbushte 86 vjet në fund të mandatit të ardhshëm, po punon për ta garantuar një elektorat skeptik se ai është ende i aftë mendërisht dhe fizikisht për të lulëzuar në punën më të rëndësishme në botë.

Ai përballlet me mosmarrëveshje

brenda bazës së partisë së tij, ku ka pakënaqësi se ai nuk ka bërë më shumë për ta ndaluar luftën e Izraelit kundër Hamasit - grupit të shpallur terrorist nga ShBA në Gazë. Aktivistët dhe liderët fetarë në Uashington i nxitën demokratët të votojnë "i pavendosur" si shenjë zemërimi.

Ish-ndihmësi i Navalnyt zotohet për vazhdimin e luftës, megjithëse u sulmua me çekan

MOSKË, 13 MARS - Leonid Volkov, një ish-ndihmës i afërt i liderit të ndjerë opozitar rus Alexei Navalny, është zotuar se do ta vazhdojë luftën kundër presidentit të Rusisë, Vladimir Putin, me gjithë lëndimet që i pësoi pasi u sulmua më 12 mars nga një person i paidentifikuar në Vilnius të Lituanisë. "Do të vazhdoj të punoj dhe nuk do të dorëzohem", tha Volkov në një video të publikuar në Telegram, pasi u lirua nga spitali në kryeqytetin lituan. "Ata deshën të më shndërronin në biftek. Natyrisht, me një çekan mishi. Një burrë më sulmoi mu pranë oborrit të shtëpisë sime", tha Volkov.

Ai e theu dorën dhe pësoi



lëndime të tjera për pasojë.

Volkov e cilësoi sulmin si "një përshëndetje karakteristike prej gangsteri nga Putini".

Zëdhënësi i Policisë lituane, Ramunas Matonis, konfirmoi për agjencinë e lajmeve AFP se një qytetar rus u sulmua pranë

shtëpisë së vet në Vilnius rreth orës 22:00 më 12 mars, pa e përmendur me emër Volkovin.

Sipas gazetarit Sergei Parkhomenko, siç raporton "Meduza", Volkov jeton në një lokalitet të vogël jashtë Vilniusit. Ministri i Jashtëm i Lituanisë, Gabriellus Landsbergis, e përshkroi sulmin si "tronditës". Pamje të Volkovit të lënduar dhe të veturës së tij të dëmtuar u postuan në Telegram nga ekipi i Navalnyt.

Sulmi u raportua së pari nga Kyra Yarmysh, ish-zëdhënësjë e Navalnyt dhe sekretarja e Fondacionit të tij Kundër Korrupsionit (FBK), e cila tha në rrjetin social X se një burrë i paidentifikuar e theu dritaren e

veturës së Volkovit dhe hodhi gaz lotsjellës drejt syve të tij para se ta godiste me çekan mishi. Më vonë, ajo tha se Volkov e luftoi sulmuesin duke përdorur "derën e veturës dhe këmbët e tij".

Navalny, kritiku më i madh i Putinit, vdiq muajin e kaluar në rrethana të dyshimta në moshën 47-vjeçare në një burg në rajonin arktik të Rusisë, ku po kryente një dënim me 19 vjet burgim.

Volkov dhe disa aleatë të tjerë të Navalnyt u larguan nga Rusia më 2019, pasi autoritetet filluan një hetim ndaj FBK-së dhe veprimtarisë së saj. Ai u fut në listën e personave të kërkuar më 2021 për shkak të veprimtarisë së tij kundër Kremlinit.

ShBA-ja do t'i dërgojë Ukrainës ndihmë ushtarake në vlerë të 300 milionë dollarëve

UASHINGTON, 13 MARS - Administrata e presidentit amerikan Joe Biden ka thënë se do të dërgojë në Ukrainë ndihmë ushtarake në vlerë të 300 milionë dollarëve, paketën e parë të ndihmës që disa muaj, teksa projektligji për një paketë të madhe të ndihmës vazhdon të jetë i bllokuar në Kongresin amerikan. Shtëpia e Bardhë ka shqyrtuar

mundësi të shumta për të dërguar më shumë ndihmë ushtarake në Ukrainë, pasi ndihma paraprake prej Kongresit i është dërguar në tërësi Kievit në dhjetor të vitit të kaluar.

Këshilltari amerikan për Siguri Kombëtare, Jake Sullivan, u ka thënë gazetarëve se fondet do të nisen prej Pentagonit, i cili ka kursyer para prej kontratave.

Ndihma në vlerë të 300 milionë dollarëve është ndarë prej buxhetit gati 840 miliardë dollarësh të Pentagonit.

Sullivan kanë thënë se fondet do të përdoren për të dërguar artileri dhe municione për sistemet raketore amerikane HIMARS në Ukrainë. Ai ka thënë se ndihma do t'i ndihmojë ushtrisë vetëm për disa javë.



Escobari në Prishtinë: Kosova dhe Serbia t'i zbatojnë marrëveshjet

I dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, u bëri thirrje të mërkurën Kosovës dhe Serbisë të hedhin hapa përpara drejt zbatimit të marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre, ndërsa theksoi rëndësinë e themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Pas një takimi në Prishtinë me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, zyrtari i lartë amerikan ka theksuar se nuk është përpjekje e njëanshme që vetëm Kosova t'i marrë vendimet e zorshme për ta bërë këtë marrëveshje realitet

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 MARS - I dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë të mërkurën, pas takimit me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, se Kosova dhe Serbia duhet ta vazhdojnë zbatimin e plotë të marrëveshjeve të arritura në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian (BE).

Ai i hodhi poshtë pretendimet e presidentes Osmani se BE-ja po tregon mungesë të qasjes së barabartë në ndërmjetësimin e dialogut. "Të dyja palët duhet ta vazhdojnë zbatimin e plotë të marrëveshjes, pra nuk është përpjekje e njëanshme që vetëm Kosova t'i marrë ato vendimet e zorshme për ta bërë këtë

marrëveshje realitet", ka theksuar Escobari.

Osmani tha se është jetike të ketë zbatim të plotë të marrëveshjeve të arritura vitin e kaluar mes palëve. "Prandaj, qasja selektive vetëm ndaj neneve të caktuara të marrëveshjes bazike nuk do të ndihmojë, sepse të gjitha nenet kanë rëndësi", ka deklaruar Osmani. Ajo shtoi se angazhimi dhe roli i Shteteve të Bashkuara mbetet kyç "për një përmblyje të suksesshme të dialogut që do të dërgonte në një njohje të ndërsjellë, ashtu siç e ka përmendur në letrën e tij të fundit presidenti [amerikan Joe] Biden".

Me ndërmjetësimin e BE-së, Kosova dhe Serbia arritën Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve më 27 shkurt të vitit 2023. Marrëveshja për

normalizim, prej 11 nenesh, ndër të tjera, parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

BE-ja ka thënë se marrëveshja, e cila edhe pse nuk është nënshkruar, është detyrim për palët, ende nuk ka nisur të zbatohet.

Gjatë takimit me Osmanin, Escobaro tha se bisedoi edhe për sigurinë dhe se Shtetet e Bashkuara ndihen të shqetësuara pas sulmit të 24 shtatorit në Banjskë të Zveçanit, kur një grup serbësh u përleshën me Policinë e Kosovës, ku u vranë një polic dhe tre sulmues.

"Në takim e patëm një bisedë shumë të sinqertë lidhur me gjendjen e sigurisë. Jemi tepër të shqetësuar për ndarjet e 24 shtatorit. E ftojme Serbinë që të gjithë ata që janë përgjegjës të dalin para drejtësisë dhe të japin llogari të plotë", tha Escobari. Përgjegjësinë për atë sulm e mori Millan Radoičiq - ish-nënkryetar i Listës Serbe - i cili e kaloi një ditë në paraburgim në Serbi dhe më pas doli për t'u mbrojtur në liri, por me kushtin që të mos largohet nga Serbia.

Osmani tha se Kosova do të vazhdojë të punojë me aleatët në mënyrë që "kufiri ynë të jetë i sigurt dhe të parandalohen sulme të tilla".

Në lidhje me ndalimin e dinarit serb, Escobari tha se ndodhet në Kosovë për të biseduar për mënyrat e gjetjes së një

zgjidhjeje.

Presidentja Osmani e përsëriti se kjo çështje duhet të zgjidhet në bashkëpunim me aleatët.

Gjatë vizitës së tij, Escobari pritet të takohet edhe me kryeministrin Albin Kurti, opozitën dhe përfaqësuesit e komunitetit serb, për të biseduar për çështjen e dinarit serb.

Banka Qendrore e Kosovës e filloi zbatimin e një rregulloreje të re nga 1 shkurti, e cila përcakton që vetëm euroja të përdoret për pagesa me para të gatshme, duke i dhënë fund përdorimit të dinarit serb.

Escobari, gjatë një bashkëbisedimi të hapur me gazetarë në Bruksel të martën, e quajti "katastrofik" dhe "jokompetent" vendimin e autoriteteve të Kosovës për ta zbatuar këtë rregullore.

Serbia deklaroi se ndan miliona euro për serbët në Kosovë dhe ua paguan atyre rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë. Në mungesë të dinarëve në vendbanimet e tyre në Kosovë, serbët e Kosovës të martën udhëtuan dhjetëra kilometra drejt qyteteve serbe në afërsi të kufirit me Kosovën për t'i tërhequr mjetet që ata pranojnë nga Qeveria e Serbisë.

Escobari i ka përmendur disa arsye pse ShBA-ja nuk pajtohet me mënyrën e zbatimit të rregullores së BQK-së: shpejtësia me të cilën është zbatuar, mungesa e ofrimit të ndonjë alternative për t'i pranuar paratë, nuk janë kontaktuar komunitetet e prekura prej vendimit, komuniteti ndërkombëtar ka pasur vështirësi që ta bindë Kosovën që të ofrojë ndihmë teknike. "Qeveria e Kosovës duhet të punojë me komunitetin ndërkombëtar për të gjetur zgjidhje për këtë vendim, që do ta quaja katastrofik dhe madje jokompetent, të zbatimit të vendimit që ka krijuar kaos në ekonominë e Kosovës", ka thënë ai.

Escobari ka përsëritur që Shtetet e Bashkuara nuk e kundërshtojnë legjitimitetin e vendimit, mirëpo kanë probleme me mënyrën e zbatimit dhe për ndikimin që ka te komuniteti serb.

Hoxhaj, kritika për qeverinë Kurti për sjelljen me amerikanët dhe evropianët

Prishtinë, 13 mars - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, ka kritikuar qeverinë Kurti në raport me sjelljen që tregon me amerikanët dhe evropianët. Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Hoxhaj, ka thënë se sot, pas agresionit në Banjskë, duhet të ishte një

kryetëmë në tavolinë, një marrëveshje bilaterale e sigurisë me ShBA-në dhe anëtarësim në NATO me shtetet perëndimore. "Sjellja e Qeverisë së Kosovës në raport me amerikanët dhe evropianët tregon që ajo është shumë e dobët për një ambicie të vërtetë politike

dhe shumë e fort për një krenari boshe naive, ku sot pas agresionit në Banjskë, duhet të ishte një kryetëmë në tavolinë, një marrëveshje bilaterale e sigurisë me ShBA-në dhe anëtarësim në NATO me shtetet perëndimore!", ka shkruar Hoxhaj në "Facebook".





Kurti 'lëshon bajrakun', urdhëron kalimin e pronave Manastirit të Deçanit

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka lëshuar të mërkurën 'bajrakun' në lidhje me pronat për Manastirin e Deçanit. Ai ka thënë të mërkurën se qeveria e tij i ka kërkuar Agjencisë Kadastrale të Kosovës ta zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të vitit 2016 për tokën e Manastirit të Deçanit. Kurti ka thënë se ndonëse Qeverisë së Kosovës nuk i pëlqen vendimi, të cilin e ka cilësuar "të çuditshëm" dhe "të padrejtë", ajo nuk ka mjete ligjore dhe juridike për ta anuluar vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ky vendim i Kurtit ka nxitur reagime të shumta në vend, pasi që përgjatë gjithë së kaluarës së tij politike, Kurti dhe partia që udhëheq kanë qenë kundër zbatimit të një vendimi të tillë

Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës, gjatë Asamblesë Parlamentare të këtij institucioni që do të mbahet në prill.

Kurti ka thënë se ndonëse Qeverisë së Kosovës nuk i pëlqen vendimi, të cilin e ka cilësuar "të çuditshëm" dhe "të padrejtë", ajo nuk ka mjete ligjore dhe juridike për ta anuluar vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Shefi i ekzekutivit ka thënë se nuk do të ndryshojë qëndrimi i qeverisë ndaj "këtij vendimi të dëmshëm asnjëherë", por se, në anën tjetër, nuk ka dyshim se anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës "do të ishte jo vetëm fitore historike, por edhe një hap gjigant për republikën tonë drejt njohjes nga pesëshja evropiane, që mundëson anëtarësimin në NATO dhe në Bashkimin Evropian për Kosovën e pavarur".

Kurti, po ashtu, ka bërë me dije se ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, i ka dërguar notë verbale njoftuese Këshillit të Evropës, përderisa ka theksuar se procesi i vendimmarrjes për anëtarësimin e Kosovës do të përfundojë në maj. "Më 22 mars është mbledhja e

jashtëzakonshme e komunitetit atje, nga mesi i prillit është Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, dhe në fund të majit është shqyrtimi nga Këshilli i Ministrave, në Këshillin e Evropës, që vendos për anëtarësimin tonë", tha ai.

Ramosaj nuk pajtohet me vendimin e qeverisë

Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se Deçani përsëri goditet padrejtësisht, kësaj radhe nga një urdhër ekzekutiv i kryeministrit të Albin Kurtit. "Deçani së pari është goditur padrejtësisht në vitin 2008, kur u krijua 'Zona e Veçantë e Mbrojtur', e cila bëri ndalimin e plotë dhe kufizimin e pajustificueshëm në: ndërtimin e rrugës, ndërtimin e shtratit të Lumbardhit, në ndalimin e shfrytëzimit të 'Pushimores së Fëmijëve', e ndaloi plotësisht zhvillimin ekonomik dhe ndërtimin në prona private brenda kësaj zone. Parku Kombëtar 'Bjeshkët e Nemuna' i vitit 2012, e ndaloi dhe kufizoi mundësinë për të jetuar më mirë në këtë qytet, mundësinë e zhvillimit të kësaj komune,

implementimin e shumë projekteve strategjike, të cilat tanimë është dashur të jenë të përfunduara. Park Nacional i cili është bërë pengesë shtesë e zhvillimit ekonomik. Vendimi për fillimin e bypass-it, ndërrimin e destinimit të rrugës R108 - viti 2014. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2016, për 24 hektarë të pronave, i cili u zbatua sot nga Agjencia Kadastrale e Kosovës me urdhëresë të kryeministrit. Qe tri vjet po pres që ky kryeministër të më takojë një herë të vetme, për të diskutuar edhe për këtë temë për të cilën dha urdhër ekzekutiv sot! 'Kur nuk je i zoti të bësh një hair në këtë vend, është mirë të mos i bësh as sherr këtij vendi!', ka thënë Ramosaj në deklaratën për medie.

Ish-bashkëpartiaqi i tij, tash deputet i pavarur në Kuvendin e Kosovës, Haki Abazi, ka thënë se Kurti shkeli edhe një kauzë. "Edhe një kauzë e shkelur, edhe një gënjeshtër e konfirmuar, dorëzim para eksterritorialitetit të kishës, zbatimi i marrëveshjes në mënyrë të njëanshme. Po të ishte Kurti në opozitë sot e kishte pështyrë veten në fytyrë, 'aktivistët' i kishte shtyrë drejt vdekjes dhe Policinë e Kosovës do ta fyente godiste me tulla. Ky

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 13 mars - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën se qeveria e tij i ka kërkuar Agjencisë Kadastrale të Kosovës ta zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të vitit 2016 për tokën e Manastirit të Deçanit. Kurti edhe sa ishte opozitës dhe tash së fundmi në pushtet, në deklarime të tij në medie e kishte kundërshtuar vendimin e

Gjykatës Kushtetuese që t'ia lejojë Manastirit të Deçanit t'i regjistrojë 24 hektarë tokë dhe pyll, duke pretenduar se kjo pronë nuk i takon manastirit. Se është vendim i padrejtë ky, Kurti e konfirmoi edhe të mërkurën. Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, në paraditen e 13 marsit, kryeministri ka thënë se kjo është bërë për shkak se zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese, që kërkon transferimin e 24 hektarëve tokë të Manastirit të Deçanit, do të ishte vendimtar për aplikimin e

Çfarë ka në 24 hektarët përreth Manastirit të Deçanit?

PRISHTINË, 13 MARS - Që nga përfundimi i luftës në vitet 1998-'99 në Kosovë, Manastiri i Deçanit, i cili gjendet në pjesën perëndimore të vendit, kërkon marrjen në pronësi të një sipërfaqeje prej rreth 24 hektarësh. Kjo tokë, që ndodhet përreth këtij manastiri, në kadastrë është e shënuar si pronë e dy ndërmarrjeve "Iliria" dhe "Apiko", e para hotel, e dyta fabrikë mjalti. Pronësia e Manastirit të Deçanit mbi këta 24 hektarë tokë u konfirmua nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës në maj të vitit 2016. Por, këtë vendim autoritetet lokale të Deçanit nuk e zbatojnë as sot e kësaj dite, duke vlerësuar se kjo sipërfaqe u mor me dhunë në vitet '90 nga regjimi i udhëheqësit të atëhershëm serb, Slobodan Millosheviq.

Nga Manastiri i Deçanit i kanë thënë më herët REL-it se në vitin 1997, manastirit, në fakt, iu kthyen 24 nga gjithsej 700 hektarët tokë, të cilët i janë marrë në vitin 1946 nga pushteti komunist i Jugosllavisë së atëhershme.

Çfarë ka në këtë sipërfaqe dhe pse është e rëndësishme për Deçanin?

Përveç tokës bujqësore dhe pyllit, në këta 24 hektarë ndodhen edhe dy objekte hoteliere, me rreth 10 objekte të vogla përcjellëse, si dhe objekti i një ndërmarrjeje që në kohën e paraluftës njihet për prodhim të mjaltit. Këto objekte me kalimin e viteve u dëmtuan dhe shkatërruan.

Rreth 500 metra larg Manastirit të Deçanit, i fshehur mes pishave të larta, ndodhet objekti i hotelit "Iliria". Ky hotel ishte ndër më të njohurit e kësaj ane në vitet '70 dhe '80. Përveç që punësonte mesatarisht rreth 40

punëtorë, ai kishte fluks të madh vizitorësh, sidomos gjatë sezonit të verës.

Ky objekt - tani nën mëshirën e fatit - ndaloi së punuari në vitet '90, kur regjimi i atëhershëm serb vendosi masa të dhunshme në Kosovë, duke mbyllur shumë institucione dhe ndërmarrje.

Inventari dhe gjërat e tjera përcjellëse u vodhën apo u dëmtuan në masë të madhe pas luftës, më 1999.

Hoteli tjetër që nuk i shihet fundi

Në skaj të hotelit "Iliria" ndodhet një kompleks tjetër hotelier. Ndërtimi i tij nisi para luftës, në vitet 1998-'99, por punimet nuk u finalizuan.

Tensionimi i situatës politike atëbotë dhe fillimi i luftës bënë që punimet të ndërpriteshin. Në hapësirat e brendshme vërehet se hoteli parashihej të kishte dhjetëra salla dhe një numër të madh dhomash. Aty tani ka vetëm mbetje të ndërtimit. Për këtë hotel nuk ka të dhëna për sipërfaqen, por ajo duket mjaft e madhe.

Objekti i bletarisë "Apiko" është i boshatisur dhe i rrethuar me tela. Aty ka vite që nuk ka shkelur këmbë punëtori. Që nga viti 1999 objekti i kësaj ndërmarrjeje është nën kujdesin e trupave të misionit paqeruajtës të KFOR-it. Hyrja në të është e ndaluar. Për shkak të afërsisë me një pikë kontrolli të KFOR-it, fotografimi i objektit është i mundur vetëm nga një distancë e largët. Këtu kanë punuar rreth 30 punëtorë deri në fillim të viteve '90. Si shumë ndërmarrje të tjera, edhe "Apiko" ndaloi së operuari për shkak të tensionimit të situatës politike.

Të gjitha këto objekte dhe vetë objekti i Manastirit të Deçanit



ndodhen brenda asaj që me ligj kualifikohet si Zonë e Veçantë e Mbrojtur dhe përfshin gjithsej 839 hektarë.

Kuvendi i Kosovës në vitin 2008 miratoi Ligjin për Zona të Veçanta të Mbrojtura, i cili duhet të sigurojë mbrojtjen e manastireve ortodokse serbe, kishave, vendeve të tjera fetare, si dhe vendeve historike dhe kulturore të një rëndësie të veçantë për komunitetin serb, si dhe për komunitetet e tjera në Republikën e Kosovës.

Në zona të tilla nuk lejohen ndërtime e as zhvillim i projekteve infrastrukturore, por kjo s'e pengoi manastirin që të shtojë rrethoja guri dhe objekte të tjera përgjatë viteve.

"Humbjet janë të mëdha"

Përveç institucioneve komunale dhe atyre qendrore, pronësinë e Manastirit të Deçanit mbi 24 hektarë tokë nuk e njohin as disa qytetarë me të cilët bisedoi Radio Evropa e Lirë.

Miftar Januzaj, 63 vjeç, nga fshati Isniq i Deçanit, i cili ka punuar 15

vjet në kompleksin e pushimores "Pishat e Deçanit", thotë se bllokimi që i është bërë hapësirës dhe ndërmarrjeve pranë manastirit, ka shkaktuar dëme të mëdha për banorët. "Manastiri i Deçanit është vend kulturor, por nuk do të thotë se ka të drejtë t'i marrë pronat që nuk i takojnë. As ne nuk i marrim të manastirit, por as manastiri të mos na i marrë tonat", shprehet Januzaj. Pushimorja e fëmijëve "Pishat e Deçanit" është në kuadër të Zonës së Veçantë të Mbrojtur. Ajo ruhet nga KFOR-i. Fotografimi i saj ishte i pamundur. Por, siç shpjegon Januzaj, pushimorja ka pasur një kapacitet të madh të akomodimit. "Ka qenë një vend ku kanë ardhur fëmijë nga e gjithë Kosova. Ka qenë një pushimore e të gjitha komunave. Ka qenë një pushimore me kapacitet prej 510 shtretërisht. Ka qenë vend tejet piktoresk", thotë Januzaj.

Profesori dhe autori i librit "Resurset malore të Deçanit dhe turizmi", Adem Lushaj, thotë se bllokimi i objekteve të kompleksit hotelier "Iliria" dhe fabrikës së mjaltit "Apiko" e ka penguar zhvillimin ekonomik të komunës së Deçanit. Ai është kundër vendimit që manastiri t'i marrë në pronësi 24 hektarët tokë përreth tij pasi, siç thotë, të vetmit pronarë të asaj toke dhe objekteve përcjellëse janë dy ndërmarrjet: "Iliria" dhe "Apiko". "Humbjet janë të mëdha si në aspektin e punësimit, ashtu edhe të generimit të të hyrave, kur dihet se turizmi është një sektor i zhvillimit ekonomik - tejet i rëndësishëm për komunën e Deçanit", shprehet Lushaj.

Lushaj thotë se në kompleksin hotelier "Iliria", në fabrikën e mjaltit "Apiko" dhe në pushimoren "Pishat e Deçanit", kanë punuar rreth 100 punëtorë. "Sipas një statistike që e kemi marrë, fabrika e mjaltit i ka

pasur deri në 25 punëtorë, ndërsa kompleksi hotelier "Iliria" ka qenë shumë i frekuentuar dhe ka pasur deri në 40 punëtorë", thotë Lushaj. Sipas tij, rreth 40 punëtorë të tjerë, varësisht nga sezoni, kanë qenë të angazhuar edhe në pushimoren e fëmijëve "Pishat e Deçanit".

Komuna e Deçanit dhe drejtoritë përkatëse, përfshirë Kadastrën, refuzojnë t'i lejojnë Manastirit të Deçanit që t'i regjistrojë në kadastrë këta 24 hektarë.

Ato pretendojnë se kjo sipërfaqe u takon ndërmarrjeve shoqërore "Apiko" dhe "Iliria" dhe se nuk i kanë takuar asnjëherë Manastirit të Deçanit.

Jo vetëm institucionet lokale në Deçan, por edhe Qeveria e tanishme e Kosovës, si dhe disa qeveri të kaluara, kanë shprehur haptas bindjen se Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka "legalizuar" vendimin e ish-presidentit të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ), Slobodan Millosheviq, të vitit 1997, kur ai ka vendosur t'ia dhurojë atë pronë Manastirit të Deçanit.

Në një formë apo tjetër, këtë mendim e kanë shprehur edhe kryeministri aktual i Kosovës, Albin Kurti, si dhe presidentja Vjosa Osmani. Por tashmë Kurti ka ndryshuar qëndrim. Kryeministri Kurti ka thënë të mërkurën (13 mars, 2024) se Qeveria e tij i ka kërkuar Agjencisë Kadastrale të Kosovës ta zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të vitit 2016 për tokën e Manastirit të Deçanit.

Kërkesa të vazhdueshme për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese - autoritetit përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës - kishte nga shtetet e Quint-it: Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania dhe Italia.



as sa Gerry Adams nuk është", ka reaguar Abazi në "Facebook". Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj, ka ironizuar me kryeministrin Albin Kurti lidhur me pranimin e vendimit për tokat e Manastirit të Deçanit. Në "Facebook", Lekaj e quan "patriot" kreun e qeverisë. "Hahaha... Ku je o Albin patrioti? A e lëshove bajrakun a?", ka shkruar Lekaj.

Ndërkombëtarët përshëndesin vendimin e qeverisë për Manastirin

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për Manastirin është përshëndetur menjëherë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në një konferencë

për medie, pas takimit me presidenten Vjosa Osmani në Prishtinë, i dërguari i posaçëm amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se "aq sa ishte i rëndësishëm dhe i vështirë, vendimi i sotëm për Manastirin ishte shumë i domosdoshëm". Zbatimi i vendimit për Manastirin e Deçanit është mirëpritur edhe nga ambasadori gjerman në

Prishtinë, Jorn Rohde. Përmes një postimi në "X", diplomati gjerman tha se, pavarësisht se zbatimi i këtij vendimi është i vonuar, ai paraqet "një hap të rëndësishëm në angazhimin e Kosovës për sundim të ligjit". Edhe ambasadori i BE-së, Tomas Szunyog, e ka mirëpritur vendimin e Qeverisë së Kosovës për pronat e Manastirit të Deçanit. Ai në platformën "X"

tha se kjo është një ditë e mirë për Kosovën për zbatimin e ligjit. "Një ditë e mirë për sundimin e ligjit në Kosovë!", ka shkruar ai. Ndërkaq kreun e misionit në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Michael Davenport, tha se zbatimi i vendimit për Manastirin e Deçanit "do ta ruajë respektin për sundimin e ligjit".

Reagim i KMDLNj-së

Paramilitarët e Gjykatës Raciste Speciale vazhdojnë orgjitë e bastisjeve!



Ditëve të fundit janë shpeshuar bastisjet e paramilitarëve të pidentifikuar si forcë policore e ndonjë institucioni ndaj personave që, në një mënyrë apo tjetër ishin pjesë e luftës çlirimtare apo pjesë e ndërtimit të institucioneve të Kosovës. Kryesisht janë të interesuar të marrin telefona celularë apo materiale që pastaj me metoda alkimike i përkthejnë si ndërhyrje në drejtësi përmes joshjes apo frikësimit të dëshmitarëve. Bastisja e shtëpisë së Sylejman Selimit, jo si person i dyshuar por si një vend ku kërkohet dëshmi, biseda me Sami Lushtakun në bazën e EULEX-it në Fushë-Kosovë, gjithashtu si person jo i dyshuar paraqesin raste flagrante të privatësisë dhe shqetësim i familjeve të tyre. Të paftuar vizituan edhe shtëpinë e Hajredin Kuçit, pjesë e ekipit mbrojtës të Kadri Veselit. Presioni mbi Kuçin bëhet me qëllim që ta largojnë nga ekipi mbrojtës duke e ditur kapacitetin intelektual dhe profesional në fushën e drejtësisë. Nga burime të sigurta KMDLNj ishte informuar se disa ditë më parë vetura dhe persona të panjohur vëzhgonin shtëpitë e Sylejman Selimit dhe Hajredin Kuçit për t'i "vizituar" pastaj përmes vizitave dhe bastisjeve. Me të filluar bastisjen, KMDLNj ka informuar disa media dhe nga një largësi e vogël ka monitoruar këto bastisje nga

policë të pauniformuar, të pajisur me një distinkt identifikues, me kompetenca të pakufizuara e që nuk i japin asnjë llogari institucioneve të Kosovës në ndërkohë që Policinë e Kosovës, të cilës aspak nuk i besojnë e përdorin si "fuqi krahu". Metodat e bastisjes në orët e hershme të mëngjesit, paramilitarët e Speciales i kanë trashëguar nga policia e Serbisë sikur edhe joshjen dhe shantazhimin e dëshmitarëve. Pas këtyre bastisjeve ka reagime të personave të njëjtë, sa për të

thënë dhe reagime të zbehta partiake. Institucioni që e ka për detyrim të reagojë, të kërkojë llogari dhe transparencë meqë sillet dhe thirret se është themelues i kësaj gjykate, Kuvendi i Kosovës e luan lojën e strucit për shkak të mungesës së guximit, oportunitizmit, mungesës së moralit elementar dhe integritetit intelektual dhe profesional. Për më keq shumica e deputetëve, në heshtje, disa edhe publikisht e përkrahin këtë gjykatë prandaj edhe e kanë zgjedhur gjuhën e peshkut, të heshtjes jonormale. Për KMDLNj është i habitshëm mungesa e reagimit të krahut të luftës që mrizojnë në Kuvendin e Kosovës dhe jashtë tij. Partitë në pushtet po e bëjnë të mundurën dhe të pamundurën t'ua rëndojnë gjendjen pengjeve të Hagës, familjeve të tyre dhe të gjithë atyre që nuk pajtohen me këtë gjykatë, që nga pakësimi drastik i mjeteve të parapara për mbrojtje ligjore e deri te mungesa e interesimit elementar për fatin e të burgosurve, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës, ende të pafajshëm sepse nuk

janë dënuar me një vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente. Asnjë qeveri dhe vend i rajonit nuk është sjell me aq shpërfillje ndaj qytetarëve të saj në raste të ngjashme sikur që asnjë vend apo qeveri nuk ka treguar aq entuziazëm për t'i shpallur fajtorë dhe dënuar sikur që e bënë qeveria e tashme. Për shkak të ndërhyrjes klandestine dhe të qëllimshme në Udhëzimin Administrativ nga ministrja aktuale e Drejtësisë e që jashtëzakonisht pakëson mundësitë për një mbrojtje efektive juridike, dikush duhet t'i nënshtrohet përgjegjësisë penale, nëse jo tani, në të ardhmen, pa asnjë dyshim. Urrejtja ndaj krerëve të UÇK-së, bartësve më të lartë të posteve institucionale në Kosovë, themeluesve të shtetit është e pashembullt, patologjike dhe përpjekje që, bashkë me Gjykatën Speciale Raciste të Hagës ta rishkruajnë historinë e Kosovës për të krijuar vende për protagonizmin e tyre ndonëse nuk e dhanë asnjë kontribut për luftën, lirinë dhe formimin e shtetit të Kosovës, përkundrazi, e bënë të kundërtën.

Me bastisje të shpeshta paramilitarët e Speciales skajshmërisht po e provokojnë situatën e sigurisë duke e testuar durimin e shqiptarëve. Ky durim i ka disa vija të kuqe dhe askush nuk mund të presë se ngjarjet do të zhvillohen sipas dëshirave të mashtrueses Trandafillova, kuadër i Bullgarisë komuniste e mësuar me këso procese të montuara politike. Policia e Kosovës nuk duhet të jetë inferiore dhe e nëpërkëmbur nga paramilitarët e Hagës e që nesër do të kritikohet për këtë. Të arrestuarit nuk duhet t'ua japin telefonat celularë këtyre "policëve" të panjohur e as t'ua hapin dyert e shtëpive të tyre vullnetarisht. Nuk duhet të lejojnë që t'iu shkelet privatësia apo t'iu dhunohet familja dhe shtëpia. Kuvendi i Kosovës duhet të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme çdo herë që është e nevojshme për të kërkuar respektimin e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria që janë në Hagë, të kërkojnë transparencë më të madhe dhe llogaridhënie, një afat të arsyeshëm të kohëzgjatjes së procesit gjyqësor dhe krijimin e kushteve të pakufizuara për mbrojtje juridike, deri në plotfuqishmërinë e dënimit të shqiptar. Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë që Gjykata Speciale t'i mbulojë shpenzimet për avokatët mbrojtës, kompensim material për të burgosurit që shpallen të pafajshëm si dhe t'i kompensojë viktimat. Përfundimisht, Kuvendi i Kosovës duhet publikisht të deklarohet nëse kjo gjykatë është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës, nëse gjykon sipas ligjeve të Kosovës, në të kundërtën duhet të distancohet qartë nga kjo gjykatë duke e adresuar përgjegjësinë për këto padrejtësi juridike dhe shkelje flagrante të drejtave të njeriut ndaj pengjeve të Hagës, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës. Kjo adresë e përgjegjësisë është në Hagë, në Gjykatën Speciale Raciste e jo në Kosovë.



Shala: A po rrezikohet procesi i regjistrimit të popullsisë qëllimisht për herë të tretë?

Prishtinë, 13 mars - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka thënë se qeveria Kurti është duke planifikuar që në të njëjtën kohë t'i mbajë zgjedhjet në veri dhe ta bëjë regjistrimin e popullsisë. Ai ka thënë se realizimi i këtyre dy proceseve në të njëjtën kohë bie ndesh me ligjin. Shala ka hedhur dyshime se kryeministri Albin Kurti është duke bërë lojë të qëllimshme politike në lidhje me këto dy

proceset. "Ligji për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, kapitulli IV, neni 22, pika 3 thotë: 'Regjistrimi i popullsisë nuk realizohet në situata të veçanta, si: zgjedhjet qendrore, lokale, trazirat sociale dhe faktorë të jashtëm në një periudhë jo më pak se gjashtë (6) muaj para regjistrimit. Në raste të jashtëzakonshme, data e regjistrimit rishikohet'. A është e qëllimshme kjo lojë

politike dhe ku po na dërgon qeveria me këto veprime antiligjore? Cili nga këto procese duhet të anulohet, apo çka ndodh nëse qeveria e shkel ligjin publikisht? A po rrezikohet procesi i regjistrimit të popullsisë qëllimisht për herë të tretë radhazi, edhe pse deri më tani qeveria ka ndarë shumë mjete për përgatitjen e procesit të regjistrimit të popullsisë", ka shkruar Shala në "Facebook".



Kurti përkujton 25-vjetorin e masakrës në Tregun e Gjelbër në Mitrovicë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

MITROVICË, 13 MARS - Kryeministri Albin Kurti ka përkujtuar 25-vjetorin e masakrës në Tregun e Gjelbër në Mitrovicë. Në këtë përvjetor të kësaj masakre Kurti ishte në Mitrovicë për ta nderuar kujtimin e civilëve të vrarë nga forcat e Serbisë.

Ai së bashku me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, drejtorin ekzekutiv të Institutit për Krimet e Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, At dhe Hetemi, si dhe deputetë të Kuvendit, kanë bërë homazhe para pllakës përkujtimore të kësaj masakre.

Kurti është takuar edhe me të

mbijetuarin e kësaj masakre, Azem Beqiri. “Kjo është plagë e kësaj lirie”, na tha Azem Beqiri, i mbijetuar i masakrës së Tregut të Gjelbër në Mitrovicë. Azemi humbi bërrylin dhe sot e asaj dite i vuan pasojat nga sulmi me granatë që përgjaku Tregun e Gjelbër në Mitrovicë. ‘Dihet që Serbia dhe serbët e kanë bërë këtë. Dihet edhe kush ka dhënë urdhër’, tha Azemi, duke i bërë thirrje publike prokurorisë, që atë, bashkë me të mbijetuar të tjerë, t’i marrin si dëshmitarë”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.

Kryeministri ka bërë me dije se më 13 mars 1999, me hedhje granatash nga forcat serbe, u vranë shtatë civilë, më i vjetri 65 vjeç e më e reja vetëm 5 vjeçe. “U



plagosën rëndë 128 të tjerë, në mesin e të cilëve kishte fëmijë, gra, pleq e të rinj. Shumë prej tyre mbetën invalidë të përjetshëm. Në këtë ditë të kujtimit, s’ka si të mos na vijë në mendje masakra në tregun Markale në Sarajevë, që ishte një nga krimet më të rënda gjatë rrethimit të qytetit në vitet 1992-1995. Këto masakra në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë janë dëshmi e veprimeve

gjenocidale të Serbisë. Sulmi me granata supozohet të ketë ardhur nga një objekt ushtarak, ku ishin të vendosura forcat serbe gjatë luftës 1998-’99. Aty sot qëndron Kampi i Policisë së Republikës së Kosovës, që bartë emrin e heroit Enver Zymeri, e që garanton sigurinë, si e mirë publike që u ofrohet të gjithë qytetarëve pa dallim. Qoftë i përjetshëm kujtimi për të vrarët: Abaz Mecinaj (1944),

Ahmet Strana (1941), Elizabeta Hasani (1994), Ragip Bajrami (1946), Rrahim Peci (1934), Sevdije Selani (1949) dhe Valdete Strana (1977)”, ka theksuar Kurti. Kryeministri ka thënë se tekta nderojmë kujtimin e tyre, theksojmë domosdoshmërinë për drejtësi për viktimat e kësaj masakre dhe qindra masakrave të tjera të kryera nga Serbia në Kosovë.

Qeveria i hap rrugë blerjes së objekteve për nevojat e misioneve diplomatike të Kosovës në Paris, Romë, Otavë dhe Ankara

Prishtinë, 13 mars - Qeveria e Kosovës ka zhvilluar mbledhjen e rregullt të radhës, në të cilën ka miratuar propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për blerjen e objekteve për nevojat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës në Paris (Francë), Romë (Itali), Otavë (Kanada) dhe Ankara (Turqi). Përmes këtij vendimi i hapet rruga fillimit të procedurave të blerjes, siç parashihet në legjislacionin respektiv në fuqi.

Qeveria ka miratuar në këtë mbledhje edhe Projektligjin për të Huajt, i cili rregullon kushtet e hyrjes, kalimit transit, qëndrimit dhe daljes së të huajve në dhe nga territori i Republikës së Kosovës. Përmes tij synohet të adresohen sfidat bashkëkohore të migracionit duke paraparë masa gjithëpërfshirëse, ta rrisë sigurinë kufitare, si dhe ta promovojë integrimin e suksesshëm të të huajve në komunitetin tonë.

Po ashtu, është miratuar vendimi për themelimin e Ndërmarrjes Publike Qendrore, “Korporata e Ruajtjes së Energjisë (KRE)/ Energy Storage Corporation (ESCorp)”, Sh.A, në pronësi të Republikës së Kosovës, me njëqind për qind (100 %) aksione të

Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në zbatim të Marrëveshjes Kompakt të Sfidave të Mijëvjeçarit dhe programit të zbatimit, dhe me qëllim të mbështetjes për sigurinë energjetike dhe tranzicionin drejt një të ardhmeje më të pastër të energjisë, Republika e Kosovës synon që në sistemin e saj energjetik të instalojë 170MW kapacitet për ruajtjen e energjisë përmes baterive. Programi Kompakt parashih krijimin e një entiteti që do të ketë në pronësi dhe do të menaxhojë 125MW të kapacitetit të sistemit të ruajtjes së energjisë me bateri. Ky entitet është vendosur të jetë një ndërmarrje publike, e cila themelohet si Shoqëri Aksionare, sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe financohet nga Programi Kompakt për 5 vitet e para të operimit të saj.

Qeveria ka ndarë 76 730.00 euro për zbatimin e masës 2.1 - Subvencionimi i kredive investive të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Gjithashtu, është miratuar edhe vendimi preliminar për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme e cila preket nga realizimi i projektit: Konservimi dhe Restaurimi i Shtëpisë në Komplexin Memorial



“Masakra e Reçakut”, ZK Reçak, komuna e Shtimes.

Po ashtu, është miratuar edhe vendimi preliminar për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme, objekti i ish-Ndërmarrjes Shoqërore “Liria” në Prizren, e cila është e nevojshme për realizimin e projektit “Krijimi i hapësirave për lëvizshmërinë e trafikut dhe këmbësorëve”.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe nismën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për negociimin e marrëveshjes ndërkombëtare të partneritetit për “Menaxhimin e grant kontratës të

asistencës teknike me numër 2023/450-113 në kuadër të programit për bashkëpunim ndërkufitar Kosovë - Maqedoni e Veriut nën IPA III (2021-2027). Kjo marrëveshje ka për qëllim përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin e asistencës teknike të programit për bashkëpunim ndërkufitar Kosovë - Maqedoni e Veriut.

Qeveria në këtë mbledhje ka miratuar vendimin për rekomandimin e presidentes së Kosovës për autorizimin e ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet

Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin “Energjia Diellore Fotovoltaike në KEK - Porta Globale”.

Miratimin e qeverisë e ka marrë edhe vendimi për aprovimin e kërkesës së Akademisë së Shkencave dhe Arteve e Kosovës, për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumën prej 25 000.00 eurosh për realizimin e projektit “Enciklopedia shqiptare”.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe nismën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për negociimin e Marrëveshjes së Grantit në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Mitrovica dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Zhvillimi i Ujërrave të Zeza në Mitrovicë”.

Gjithashtu janë ndarë mjete buxhetore në shumën prej 520 000.00 eurosh për financimin shtesë të projektit “Renovimi i kulmit dhe rikonstruksioni i hapësirave të brendshme në objektin e Institutit për Mjekësi Ligjore”.

Hapet aplikimi për subvencione në bujqësi

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 MARS - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka hapur periudhën e aplikimit për pagesa direkte/subvencione për 28 nënsektorë dhe kultura bujqësore. Për sektorët të cilët do të mbështeten përmes Programit për Pagesa Direkte 2024, afati për aplikim ka filluar të mërkurën dhe përfundon më 12 prill 2024 në orën 16:00.

Në kuadër të këtij Programi, MBPZhr-ja ka vazhduar me rritjen e përkrahjes, ku mbështetja për kulturën e grurit këtë vit varion nga 464 në 564 euro për hektar. Ndërsa për kulturën lavërtare të misrit, përkrahja do të jetë 329 euro/ha për elbin, thekrën dhe tërshërën 304 euro/ha. Ndërkaq, një hektar luledielli do të subvencionohet 454 euro.

Përmes PD 2024 do të ketë rritje për vreshtarët në 1 104 euro për çdo hektar, ndërsa pemishtet ekzistuese do të subvencionohen me 504 euro/ha. Rritje të përkrahjes ka edhe për sasinë e

dorëzuar/shitur të frutave të mjedrës në 0.20 euro/kg. Risi tjetër në këtë program është rritja e përkrahjes për kulturat perimtare në fushë të hapur dhe prioritizimi i atyre që është rritur kërkesa dhe të cilat kanë shënuar rritje në eksport, ku përfshihen speci - varieteti kurtovka dhe somborka, domatja, trangujt, qepa, patatja dhe hudhra, ku për këto kultura pagesat direkte nga 500 euro/ha do të jenë 654 euro/ha, ndërsa për fasulen monokulturë pagesat direkte nga 500 euro/ha në 754 euro/ha.

Këtë vit po vazhdon përkrahja edhe për perimet e tjera në fushë të hapur me 554 euro/ha, ndërsa perimet në serra do të subvencionohen me 904 euro/ha. Bimët mjekësore dhe aromatike, si dhe bimët mjaltëdhënëse do të subvencionohen me 504 euro për hektar, si dhe do të ketë rritje të përkrahjes për sipërfaqet që janë të certifikuar në 304 euro/ha për bujqësi organike. Subvencionimi për lopë qumështore do të jetë nga 90 euro për krerë, ndërsa ka rritje të përkrahjes për kafshët e imta nga 25 euro në 30 euro për krerë, konkretisht për dhitë.



Dyfshim i përkrahjes për kafshët e mëdha nga 90 euro në 180 euro për krerë, konkretisht për buallica. Dosat në riprodhim do të subvencionohen 25 euro/krerë, si dhe vazhdon subvencionimi për zogjtë për majmëri apo broilerët me 0.20 euro për zog.

Ndryshe, fermerët/aplikuesit, që përfitojnë subvencionin për sipërfaqet e tokës bujqësore të mbjellë/kultivuar, njëkohësisht

do të përfitojnë edhe nga subvencionimi i pjesshëm i çmimit të naftës për litër, në vlerë prej 0.36 eurosh/litër, për sasinë e naftës prej 150 l/ha, e cila është e nevojshme për kultivimin e lha të tokës bujqësore, dhe është vlerë shtesë mbi subvencionimin bazë për të gjitha sipërfaqet e tokës bujqësore që pranohen për subvencionim dhe që janë të parapara për t'u subvencionuar

në këtë program.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka njoftuar se të gjithë të interesuarit, aplikimin për mbështetje në kuadër të PD 2024 mund ta bëjnë në zyrat e drejtorive komunale për bujqësi, ndërkaq në rastet kur fermerët aplikojnë për disa kultura apo aktivitete bujqësore, plotësohet dhe dorëzohet vetëm një aplikacion.

Pas shkarkimit nga qeveria, reagon ish-bordi i drejtorëve të KRU "Hidroregjioni Jugor"

PRISHTINË, 13 MARS - Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2024, ka shkarkuar bordin e drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" në Prizren dhe ka emëruar një të përkohshëm. Por, me këtë vendim të ekzekutivit nuk po pajtohet bordi i shkarkuar, i cili përmes një reagimi publik ka thënë se përgjatë kohës sa ka qenë në detyrë, ka bërë shumë punë në dobi të qytetarëve që furnizohen me ujë nga kjo kompani. "Lidhur me vendimin e qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e Bordit të KRU 'Hidroregjioni jugor' sh.a., marrë me datë 05.03.2024, ne anëtarët e këtij Bordi: Feim Fetoshi, Mirlinda Morina, Naim Kukaj, Hysni Çanta dhe Biljal Karadolami deklarojmë: Falënderojmë kryeministrin dhe Qeverinë e Kosovës që për një periudhë prej 18 muajsh na mundësoi që të përfaqësojmë Bordin të kësaj Kompanie. Kemi



kënaqësinë të informojmë kryeministrin dhe opinionin publik se përkundër që u përgjysmua mandati ynë 3-vjeçar, ia dolëm të bëjmë punë të mëdha në të mirën e Kompanisë dhe të qytetarëve që furnizohen me ujë nga kjo kompani", është

thënë në reagimin për medie, duke theksuar se nuk qëndron arsytimi i ministres Rizvanolli, i dhënë në qeveri për propozimin e shkarkimit të këtij bordi. "Me përgjegjësi të plotë penale dhe morale, deklarojmë se e vërteta për këtë bord është krejt tjetër

nga ajo që ka prezantuar zonja ministresh. Ajo thotë: "Bazuar në raportin vjetor për vitin 2022 dhe raportin vjetor për 2023, Kompania Rajonale e Ujit 'Hidroregjioni Jugor' në Prizren ka devijuar nga caqet e përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve në planin e

biznesit". E vërteta është kjo: Ky bord ka vepruar vetëm 4 muaj në vitin 2022, gjersa miratimi i raportit vjetor 2023 ka qenë i planifikuar të bëhet me datë 12.03.2024, pra ende nuk ekziston raporti vjetor 2023. Tani këtu lind pyetja, si mund të bëhet përgjegjës ky bord për vitin 2022 kur ka vepruar vetëm 4 muajt e fundit të këtij viti, si dhe si mund të thirret ministresha në raportin e vitit 2023 kur të njëjtin ende nuk e ka në dispozicion, pasi i njëjti ende nuk ekziston, përkundër faktit se edhe kur të krijohet raporti në fjalë do të shihet se nuk ka devijime por përkundrazi shumë avancime", është thënë në reagimin e ish-bordit të drejtorëve të KRU "Hidroregjioni Jugor".

Ish-bordi ka theksuar se aq mirë, aq shumë dhe aq pastër kanë punuar, saqë iniciuesit e këtij shkarkimi nuk kanë qenë në gjendje të gjejnë as edhe një arsytim sado të vogël për shkarkim.

ATK-ja dhe Inspektorati i Punës iniciojnë procedurat për gjykitjen e punëdhënësve që nuk i kanë deklaruar punëtorët

Prishtinë, 13 mars - Zëvendësministri i Financave, Agon Dobruna, drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj dhe kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, Hekuran Nikçi, së bashku me ekipet e inspektorëve, kanë vizituar biznese të ndryshme në sektorët e gastronomisë dhe tregtisë në komunën e

Mitrovicës. Gjatë këtyre vizitave janë hasur punëdhënës të cilët kishin të angazhuar punëtorë të padeklaruar dhe pa kontrata të punës. Për këto raste, ATK dhe Inspektorati i Punës kanë iniciuar procedurat përkatëse për gjykitjen e punëdhënësve në fjalë.

"Fushata për identifikimin e

punës së padeklaruar do të vazhdojë edhe në ditët në vijim andaj i ftojme të gjithë punëdhënësit që të veprojnë konform ligjit të ri të ATK-së përmes të cilit parashihet që punëdhënësit të deklarojnë çdo punëtor të ri, një ditë para se punëtori ta fillojë punën", është thënë në komunikatën për medie.



DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

Dokumentet britanike për Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë, sjellin para lexuesit informacione të rëndësishme, për një ngjarje me shumë interes të historisë bashkëkohore të shqiptarëve. Janë afër 300 faqe dokumente të vjela nga Arkivat Britanike në Londër, të natyrës diplomatike, politike, shoqërore, ushtarake etj. Shumica e dokumenteve i përket korrespondencës së Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Beograd, me Ministrinë e Jashtme dhe të Komonuelthit (Foreign and Commonwealth Office - FCO) dhe një numër më i kufizuar informacionesh të përcjella nga Konsullata e Përgjithshme Britanike në Zagreb. Dokumentet përfshijnë edhe korrespondencën diplomatike të ambasadave të Madhërisë së saj, në: Athinë, Ankara, Moskë, Vjenë e deri në Abu Dhabi [Emiratet e Bashkuara Arabe], me Londrën. Pjesa më e rëndësishme e kësaj korrespondence i është bërë e njohur edhe Uashingtonit, me të cilin Londra konsultohet herë pas here dhe, siç dëshmojnë dokumentet, duket se ndanin edhe qëndrime të përbashkëta. Një vend të konsiderueshëm zënë edhe artikujt e shtypit të vendeve perëndimore. Imazhet e para të qëndrimeve të diplomacive perëndimore ndaj Demonstratave të vitit 1981 në Kosovë, dhe ndaj çështjes shqiptare, u përcollën pikërisht përmes këtyre artikujve. Në të vërtetë, disa prej shkrimeve

të shtypit perëndimor dhe sidomos të atij austriak e gjermano-perëndimor shprehin më qartë përmasat reale të asaj që po ndodhte në Kosovë në pranverën e vitit 1981, të egërsisë me të cilën u soll Jugosllavia ndaj demonstruesve dhe intelektualëve shqiptarë gjatë dhe pas demonstratave. Në ndonjë dokument specifik të këtij botimi do të pranohej e argumentohej juridikisht legjitimiteti dhe drejtësia e kërkesës kyçe "Kosova Republikë".

Tematika e këtyre dokumenteve është e pasur dhe e larmishme, por, përmbajtja e saj mund të rivijëzohet në disa drejtime, të cilat fokusohen: tek nacionalizmi i shqiptarëve të ish-Jugosllavisë; tek shkaqet e Demonstratave të mars-prillit të vitit 1981; tek kërkesa kryesore e tyre "Kosova Republikë"; tek roli i Shqipërisë në këto demonstrata dhe tek marrëdhëniet e saj me Jugosllavinë; tek politika zyrtare e Britanisë së Madhe ndaj Jugosllavisë dhe kërkesave të shqiptarëve; tek reagimi i organeve të larta partiake e shtetërore në Serbi e Federatë, gjatë dhe pas demonstratave; tek qëndrimet e dyzuara të udhëheqësve shqiptarë në Kosovë; tek analizat interesante për kushtetutshmërinë e kërkesës së demonstruesve "Kosova Republikë"; tek hamendësimet intriguese për vdekjen e papritur të kryeministrit të Shqipërisë, Mehmet Shehu etj. Hartuesit e dokumentacionit në

përgjithësi i gjejnë rrënjët e krizës brenda Jugosllavisë dhe jo jashtë saj, në kundërshtim me përpjekjet e udhëheqësve jugosllavë, që i kërkonin ato jashtë Jugosllavisë, kryesisht tek politika e shtetit shqiptar apo e Bashkimit Sovjetik. "Nacionalizmi në Kosovë, përmendet me të drejtë në një informacion të Ambasadës britanike në Beograd, është një problem endemik, të cilin as Tito nuk mundi ta zgjidhte". Dokumentacioni hap rrugën për një analizë më realiste e më të plotë të Demonstratave të vitit 1981 në Kosovë.

Politika zyrtare britanike e vitit 1981 ishte për ruajtjen e Jugosllavisë dhe të tërësisë së saj territoriale, ndërsa kërkesa e shqiptarëve "Kosova Republikë" shihej me dyshim dhe rrezikshmëri, sepse pranimi i saj mund t'i hapte rrugë shpërbërjes së Jugosllavisë dhe hapjes së "Kutisë së Pandorës". Sidoqoftë, nuk do të mungonin edhe gjykimet dhe zërat e veçantë jashtë kuadrit zyrtar, të cilat e konsideronin të drejtë kërkesën e shqiptarëve për barazi brenda Federatës Jugosllave. Disa artikuj të shtypit të këtyre muajve, ndonëse furnizoheshin me "karburant" nga shtypi dhe autoritetet jugosllave, arritën në konkluzione më të drejta se vetë politikanët e shteteve të tyre, duke pranuar opsionin "Kosova Republikë", madje edhe shkëputjen e saj nga Jugosllavia, duke sjellë si shembull historinë e disa vendeve evropiane.

Qeveria jugosllave, siç dëshmon dokumentacioni, qëllimisht e keqinterpretonte kërkesën e demonstruesve për "Kosovën Republikë", me shkëputjen e saj nga Jugosllavia dhe me ndryshimin e kufijve, duke e ditur se një opsion i tillë, do të prishte ekuilibrat dypolarë dhe do të kundërshtojë nga Perëndimi. Në mënyrë jo korrekte dhe të përsëritur, disa politikanë jugosllavë i referoheshin Aktit Final të Helsinkit, për pandryshueshmërinë e kufijve evropianë të vendosur pas Luftës së Dytë Botërore, duke "harruar" të përmendnin një nga nenet e tij, i cili i hapte rrugë ndryshimit të kufijve në mënyrë paqësore. Sidoqoftë, në rrethanat e "Luftës së Ftohtë" ishte gati e pamundur të "kapërceje gardhin". Frika dhe paragjykimi për tjetrin ishin të pranishëm kudo. Por, studentët, punëtorët dhe intelektualët e Kosovës nuk kërkuan ndryshimin e kufijve, por barazi me republikat e tjera të ish-Jugosllavisë. Në ndonjë dokument të këtij vëllimi vihet në dukje një tipar i veçantë i nacionalizmit shqiptar - prija drejt të drejtave kombëtare dhe jo drejt lirive individuale, sikurse ndodhte në vendet anëtare të KSBE-së, ku bënte pjesë edhe Jugosllavia. Prija për të drejta dhe liri individuale, ishte karakteristike për vendet ish-komuniste të Evropës Qendrore e Lindore, [ndonëse edhe Jugosllavia kishte problemet e veta], por, tek shqiptarët interesat kombëtare

kishin fituar prevalencë mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, për kohën kur u hartuan këto dokumente.

Dokumentet nuk i shpëtojnë dot subjektivizmit dhe këndvështrimeve të ndryshme, jo thjesht se ato janë ushqyer nga burime zyrtare jugosllave, por kryesisht për shkak të "doganës" që vë koha. Por, kjo nuk e cenon vlerën e tyre. Publikimi i këtij korpusi dokumentar do ta pasurojë më tej njohjen tonë për Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë, do të na ndihmojë të gjykojmë më mirë për historinë e saj, për njerëzit që morën pjesë dhe mbi të gjitha për drejtësinë e kërkesës "Kosova Republikë". Viti 1981 shënoi një pikë kulmore të kërkesave kombëtare të shqiptarëve, por jo fundin e një rruge të gjatë, e cila do të vazhdonte dhe do të kurorëzohej vetëm në fillim të shekullit të XXI, me shpalljen e shtetit të pavarur të Kosovës.

Shpresojmë dhe besojmë se publikimi i këtij vëllimi original dhe intrigues do të tërheqë vëmendjen e lexuesit të thjeshtë, studiuesve të shkencave shoqërore, e veçanërisht të historianëve. Interesi besojmë se do të jetë i shumëfishtë për njerëzit që bënë historinë në ato vite, të cilët janë ende gjallë. Dokumentacioni është përcjellë sipas kronologjisë së ngjarjeve, pa i cunguar e hequr pjesëza nga trupi i tyre.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Çeku: Donjeta na premtoi medalje në Lojërat Olimpike

Prishtinë, 13 mars - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka pritur në takim boksieren Donjeta Sadiku,

e cila ka siguruar normën për Lojërat Olimpike "Paris 2024". Çeku ka theksuar se Donjeta po premtonte se do të sigurojë

medalje në këto lojëra. "Vajzat po dominojnë me suksese në sport. Donjetën e prita sot në kabinet pas sigurimit të normës

olimpike për Paris 2024. Na premtoi medalje në Lojërat Olimpike. I uroj shumë suksese në Paris!", ka shkruar Çeku.



Pretendentët për titull mposhten nga Fushë-Kosova dhe Malisheva

Humbjet e Ballkanit dhe Malishevës mund t'i shkojnë përshtati Dritës, e cila, nëse fiton sot (e enjte), do ta shkurtojë dallimin e pikëve në një, përkatësisht dy pikë. Tri pikë të mërkurën ka marrë skuadra e Gjilanit, e cila e ka mposhtur Lirinë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 MARS - Fushë-Kosova dhe Malisheva e kanë hijeshuar Superligën, pasi në kuadër të javës së 25-të i kanë mposhtur dy skuadrat pretendentë për titull, Ballkanin dhe Llapin. Kampioni në fuqi dhe kryesuesi i elitës, Ballkani, pësoi humbje me rezultat 2-0 nga Fushë-Kosova. Alden Skrijelj realizoi për tri pikët e reja të "Pampurave", që renditen në vendin e nëntë me 19 pikë. Suharekasit mbesin kryesues me 51 pikë. Këtë humbje të Ballkanit nuk e shfrytëzoi Llapi që, po ashtu, pësoi humbje nga Malisheva (2-0). Drilon Hazrollaj realizoi dy

golat për malishevasit, ndërsa për mysafirët golin e vetëm e shënoi Ahmed Januzi. Malisheva e përforcon pozitën e katërt me 44 pikë, ndërsa llapjanët mbesin në vendin e dytë me 50 pikë. Fitore të rëndësishme në garë për mbijetesë ka realizuar Gjilani ndaj Lirisë me rezultat bindës 3-0. Golat i shënuan Heriq, Roganoviq dhe Basa. Gjilani zë vendin e tetë me 25 pikë, prizrenasit mbesin të fundit me 10 pikë. Të enjten zhvillohen dy ndeshjet e tjera, ku spikat përballja në mes të Prishtinës dhe Dukagjinit, klube këto që renditen në pozitën e katërt dhe të pestë. Tri pikët janë synim i klinasve dhe kryeqytetasve. Në po të njëjtën ditë zhvillohet



edhe përballja në mes të Feronikelit 74 dhe Dritës. "Nikli" do të përpiqet t'i befasojë gjilanasit dhe t'i shtojë pikët për një renditje më të mirë në renditjen tabelore, ndërsa Drita që llogaritet në garë për titull do të kërkojë fitore në mënyrë që të mbesë në hap me Llapin dhe Ballkanin.

SUPERLIGA		
Fushë Kosova - Ballkani		2-0
Gjilani - Liria		3-0
Malisheva - Llapi		2-1
Të enjten takohen: 13:00 Prishtina - Dukagjini 13:00 Feronikeli 74 - Drita		
Tabela		
	Pikë	Pikë
1. Ballkani	25	51
2. Llapi	25	50
3. Drita	24	46
4. Malisheva	25	44
5. Prishtina	24	34
6. Dukagjini	24	31
7. Feronikeli 74	24	26
8. Gjilani	25	25
9. Fushë Kosova	25	19
10. Liria	25	10

Kosova nuk i reziston Portugalisë në 'UEFA Development Tournament U16'



TIRANË, 13 MARS - Në kuadër të "UEFA Development Tournament U16" në Tiranë, Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e vajzave ka zhvilluar ndeshjen e radhës kundër Portugalisë. Pas fitores bindëse ndaj Shqipërisë (6-0), "dardanet" e reja nuk arritën t'i bëjnë ballë skuadrës e cila konsiderohet shumë më e fortë dhe me kualitet. Kosova e pa

vetën në disavantazh në minutën e 12-të, kur portugezet shënuan golin e parë. Pavarësisht prej tentimit për ta ndryshuar rezultatit, futbollistet e përzgjedhëses Albina Rrahmani nuk e patën një mundësi të tillë për t'ia arritur qëllimit në pjesën e parë. Në vazhdim të lojës, kur "dardanet" synonin ta gjejnë rrugën e golit të barazimit,

ishite sërish Portugalia e cila shënoi kur po zhvillohej minuta e 59 për rezultatit 2-0, që në fund doli të ishte epilogu i kësaj ndeshjeje. Ndonëse edhe Kosova pati raste, "dardanet" nuk arritën t'i konkretizojnë. Ndeshjen e radhës dhe të fundit në kuadër të këtij turneu, Kosova e zhvillon më 16 mars kundër Skocisë.

Rrahmani: Largohemi nga Liga e Kampionëve me kokën lart

Napoli, 13 mars - Mbrojtësi Amir Rrahmani shënoi golin e vetëm të Napolit, por që nuk ishte i mjaftueshëm për t'u kualifikuar në çerekfinale. Napoli pësoi humbje nga Barcelona me rezultat 3-1, por Rrahmani ka thënë se ata largohen nga gara më e fortë me kokën lart. "Largohemi

me kokën lart, sepse luajtëm në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe sulmuese, edhe nëse mund të kishim bërë më mirë në golat e tyre dhe të kishim shënuar golin e barazimit", ka thënë Rrahmani për "SportMediaset". "Fatkeqësisht, nëse nuk i shfrytëzoni shanset tuaja kundër

kundërshtarëve të fortë, do të detyrohemi të paguani për këtë. Ne u përpoqëm të përdornim një presion të lartë, por në të vërtetë nuk funksionoi, përkundrazi i lejoj Barcelonës të kishte disa kundërsulme. Nuk kemi bërë presion në mënyrë efektive", ka shtuar Rrahmani.



Ngannou zbulon se kush mund ta fitojë një përballje mes Furyt dhe Joshuas

BATE, 13 MARS - Francis Ngannou ka dhënë mendimin e tij në lidhje me debatin se kush do të fitonte nëse Anthony Joshua dhe Tyson Fury do të përballëshin ndonjëherë në ring. Kamerunasi, ish-kampion bote

në UFC, ka dueluar me të dy britanikët dhe ka humbur në mënyra të ndryshme ndaj të dyve. Luftëtari kamerunas pësoi një humbje mahnitëse me KO në raundin e dytë kundër Joshuas. Ndërsa kundër Furyt, ylli i MMA ia doli të

qëndrojë në këmbë deri në fund, por u mund me vendim shumicë edhe pse e hodhi një herë Furyt në tapet. "Nuk e di kush fiton, por për momentin do t'ia jepja fitoren Anthony Joshuas", ka thënë Ngannou, që në ring ende nuk ka fituar asnjë

duel, ndërkohë që është përballur me dy nga boksierët më të mirë aktualisht në botë. Kur u pyet nëse u kap i befashuar nga fuqia e Joshuas, ai shtoi: "Unë mendoj se ai mori kohën e duhur dhe më goditi. Bëhej fjalë për kohën, kryesisht.



Ndodhi diçka që nuk e prisja". Ngannou pret të rikthehet sërish në kafaz këtë vit.

Verstappeni: Nëse rivalët tanë kanë bërë një hap përpara, sërish jemi një hap para tyre

MILTON KEYNES, 13 MARS - Red Bull Racing e ka nisur mbarë sezonin 2024 të Formulës 1, me dy fitore të dyfishta në dy garat e para. Kampioni i botës Max Verstappen ka komanduar i qetë garat, duke i fituar të dyja dhe po tregon se edhe këtë sezon nuk do të ketë konkurrencë me pilotët e tjerë, madje as me shokun e tij të skuadrës. "Menjëherë u ndjeva i qetë pas timonit të RB20. Do të thosha se makina e re është një evolucion i asaj të vjetshme. Unë e ngas RB20 më natyrshëm sesa RB19 dhe është një ndjenjë e mrekullueshme", u shpreh Verstappen për "L'Equipe". "E kuptova menjëherë se ishte një makinë e shpejtë sepse ishte e ekuilibruar dhe ishte e lehtë të vendosje menjëherë një xhiro mjaft të shpejtë me kohë. Makina e vjetshme kishte vështirësi veçanërisht në pistat



qytetase, ndaj makina e re është projektuar me qëllimin e qartë për t'u përmirësuar në kthesat e ngadalta", ka thënë Verstappen. "Natyrisht ka ende disa aspekte për t'i rregulluar, të gjitha makinat kanë pikat e tyre të

dobëta. Ne kemi garuar vetëm në dy pista për t'i identifikuar ende qartë problemet tona, por këto janë detaje. Nëse rivalët tanë kanë bërë një hap përpara ne jemi sërish një hap para tyre", u shpreh Verstappen.

Bostoni komandon në NBA, humbasin Milwaukee dhe Oklahoma

SALT LAKE CITY, 13 MARS - Ekipi i Bostonit vijon të dominojë në renditjen e këtij sezoni në NBA, duke fituar me rezultat 123-107 në fushën e Utah Jazzit. Jayson Tatum me 38 pikë ishte shënuesi më i mirë për Celticsin, lider në fushë për skuadrën e tij. Minnesota fitoi me rezultat 118-100 në fushën e Clippersave dhe i bashkohet grupit kryesues në Konferencën e Perëndimit, me Oklahoman dhe Denveri, me nga 45 fitore secila. Edwardsi me 37 pikë ishte njeriu që i dha fitoren skuadrës së Minnesotas. Zhgënjën skuadra e Milwaukee,



që u mund me rezultat 129-94 nga Sacramento. Antetokounmpo realizoi 30 pikë e 13 rebounde, por që s'mjaftuan. Për vendasit u dallua Fox me 29 pikë. Indiana mposhti me rezultat 121-111 Oklahoman jashtë

fushës, një rezultat surprizë. Të gjithë titullarët e Indianas realizuan mbi 10 pikë (Turneri me 24 pikë më i miri). Fitoi edhe Memphis, që falë 24 pikëve të Jemisonit, mundi me rezultat 109-97 Washingtonin.

REZULTATET

New York - Philadelphia	106-79
Memphis - Washington	109-97
Oklahoma - Indiana	111-121
San Antonio - Houston	101-103
Utah Jazz - Boston	107-123
Clippers - Minnesota	100-118
Sacramento - Milwaukee	129-94

Ja sa trofe ka humbur Ronaldo me Al Nassrin

Eliminimi i Al Nassrit nga Championsi Aziatik shënoi një rekord negativ të Cristiano Ronaldos që kur mbërriti te sauditët vitin e kaluar. Në total janë gjashtë kompeticione të

humbura, teksa me Ronaldon Al Nassri ka fituar vetëm Kupën e Unionit të Shoqatave Arabe të Futbollit këtë sezon. Ronaldo madje do ta thellojë rekordin negativ nëse Al Nassri nuk shpallet

kampion këtë vit. Pra do të bëheshin shtatë trofe të humbur. Kupa e Mbretit dhe Superkupa e Arabisë Saudite janë gjithashtu dy trofe të tjerë në lojë për pjesën e mbetur të sezonit. Për momentin,

skuadra e drejtuar nga Luis Castro është 12 pikë prapa liderit Al Hilal të Jorge Jesus, teksa kanë mbetur vetëm gjashtë ndeshje deri në fund të kampionatit. Trofetë që ka humbur Ronaldo me Al Nassrin:

Superkupa e Riadit (2023/24), Superkupa e Arabisë Saudite (2022/23), Liga Saudite (2022/23), Kupa e Mbretit (2022/23), Riad Season Cup (2023/24), Liga e Kampionëve të Azisë (2023/24).

SHKURT

Miqësoret e marsit, Sylvinho fton nëntë lojtarë

Shqipëria do të luajë dy miqësore këtë muaj, ndaj Kilit më 22 mars dhe ndaj Suedisë më 25 mars. Për këto dy përballje, trajneri kuqez i Sylvinho do të ftojë shumë lojtarë, për t'i parë nga afër dhe për të marrë më pas një vendim për ata që do të jenë në Evropianin e verës. Mësohet se disa lojtarëve iu ka shkuar ftesa, e cila pritet të bëhet publike ditën e premte. Mbipopullim në repartin e sulmit, ku do të jenë plot nëntë lojtarë, që do të kërkojnë ta bindin trajnerin. Në listë do të jenë: Sokol Cikalleshi, Jasir Asani, Armando Broja, Rey Manaj, Ernest Muçi, Myrto Uzuni, Taulant Seferi, Mirlind Daku dhe Arbnor Muja.

Trajneri i Portos: Arteta ofendoi familjen time

Arsenali u kualifikua në çerekfinale të Ligës së Kampionëve, duke mposhtur Porton pas goditjeve të penaltive. Trajneri i skuadrës portugeze, Sergio Conceicao, akuzoi pas ndeshjes kolegun e tij të Arsenalit, Mikel Arteta, se e ka ofenduar rëndë. "Ajo që tha Arteta drejt bankinës në spanjisht ishte e rëndë. Ai ofendoi familjen time", ka thënë Conceicao. Pas përfundimit të ndeshjes, dy teknikët patën një debat intensiv në fushë. "Ai duhet të fokusohet në stërvitjen e ekipit të tij. Rezultati ishte i padrejtë, skuadra ime e meritonte të kualifikohet", ka shtuar trajneri i Portos.

14 vjet pritje për të luajtur në çerekfinale, Arteta: Janë shumë për një klub si Arsenal

Arsenali pas 14 vjetësh është kualifikuar në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Deri te ky sukses klubi anglez erdhi pasi e mposhti Porton pas ekzekutimit të penaltive. Trajneri Mikel Arteta ka thënë se kjo periudhë është shumë e madhe për një klub si Arsenal për të mos luajtur në çerekfinale. "Kanë kaluar 14 vjet që Arsenal nuk vjen në këtë fazë. Janë shumë për një klub si Arsenal. Është e jashtëzakonshme të jemi në këtë fazë të Ligës së Kampionëve. Jemi pikërisht aty ku duhet të jemi", ka thënë Arteta.

Xavi: Zhvilluam një ndeshje të madhe

Barcelona mposhti Napolin (3-1) dhe u kualifikua në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Trajneri Xavi Hernandez ka thënë se skuadra e tij ka zhvilluar një ndeshje të madhe, ndërsa për shortin e mundshëm nuk shqetësohet për faktin se Barcelona mund të konkurrojë me secilin ekip. "Skuadra zhvilloi një ndeshje të madhe. Dominuam në sulm dhe në mbrojtje. Jam shumë i lumtur që Barcelona ndodhet mes tetë ekipeve më të mira në Evropë. Shorti? Mund të konkurrojmë me të gjitha ekipet", ka thënë Xavi pas ndeshjes.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollli 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 13.03.2024 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qera.

Shpallje Publike

T-24-3

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.

Adresa e AK: Parku Industrial
MITROVICË
40000

Personi Kontaktues: Behxhet Nimani

E-mail: behxhetnimani@hotmail.com

Telefoni: +381 28 538 050

Faks: +381 28 539 202

Shpallja Publike

Qëllimi i ofertës:

- Dhënie me qera e hapësirave të objekteve dhe parcelave në Njësitë Biznisore të Trepça Sh. A.
- Sipërfaqe dhe çmimi fillestar

1. Njësia Biznisore Fabrika e Paisjes së Procesit (FPP)

Nr	Emri i Objektivit	Siperfaqja e mbuluar(m2)	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i Qerasë (€)	Siperfaqja e pa mbuluar (m2)	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)	Gjithsejt qeraja (€)
1	Depoja e bombolave	227.78	2.50	0.45	2.95	671.95	100.00	0.50	0.09	0.59	59.00	730.95
2	Reperti i ngrohësorës	182.00	0.90	0.16	1.06	193.28	350.00	0.50	0.09	0.59	206.50	399.78
3	Depoja nr 1	500.00	1.10	0.20	1.30	649.00	207.00	0.50	0.09	0.59	122.13	771.13
4	Depoja nr 2	280.00	0.90	0.16	1.06	297.36	250.00	0.50	0.09	0.59	147.50	444.86
5	Depoja nr 3	80.00	1.10	0.20	1.30	104.00	100.00	0.50	0.09	0.59	59.00	163.00
6	Depoja reprodmatialeve	400.00	0.90	0.16	1.06	424.80	-	-	-	-	-	424.80
7	Restaurani i vjetër	500.00	0.90	0.16	1.06	531.00	-	-	-	-	-	531.00
8	Ndërtesa e administratës	687.00	0.90	0.16	1.06	729.59	-	-	-	-	-	729.59

2. Njësia Biznisore Fabrika e Akumulatorëve

Nr	Objekti	Siperfaqja e mbuluar(m2)	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)	Siperfaqja e pa mbuluar (m2)	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)	Gjithsejt qeraja (€)
1	Depoja e akumulatorve	2,700.00	1.00	0.18	1.18	3,186.00	1,500.00	0.55	0.10	0.65	973.50	4,159.50
2	Depoja e garderobesë	940.00	0.90	0.16	1.06	998.28	100.00	0.55	0.10	0.65	64.90	1,063.18
3	Depoja e plastikës	500.00	1.05	0.19	1.24	619.50	650.00	0.55	0.10	0.65	421.85	1,041.35
4	Depoja e pjesëve rezervë	600.00	1.00	0.18	1.18	708.00	-	-	-	-	0.00	708.00
5	Restauranti	250.00	3.30	0.60	3.90	975.00	150.00	0.55	0.10	0.65	97.35	1,072.35
6	Depoja e gomës	1,250.00	0.90	0.16	1.06	1,327.50	150.00	0.55	0.10	0.65	97.50	1,425.00

3. Njësia Biznisore Industria Kimike

Sipërfaqet e mbuluara

Nr	Objekti	Siperfaqja e mbuluar (m2)	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)
1	Depoja e pjesëve rezervë	300.00	0.75	0.14	0.89	265.50
2	Depoja 2 e pjesëve mekanike standarde	367.25	0.75	0.14	0.89	325.02
3	Depoja e punëtorisë mekanike	825.00	0.70	0.13	0.83	681.45
4	Depoja 1 e reagjentëve	367.25	0.75	0.14	0.89	325.02
5	Ish menza e punëtorëve	200.00	1.25	0.23	1.48	295.00
6	Depoja e elektropunëtorisë	200.00	1.25	0.23	1.48	295.00

Sipërfaqet e pa mbuluara – Parcelat pranë magjistrales së Adriatikut

Nr	Emertimi i parcelës	Siperfaqja e pa mbuluar (m2)	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)
1	Parcela me numer 1 A	750.00	0.50	0.09	0.59	442.50
2	Parcela me numer 2 A	750.00	0.50	0.09	0.59	442.50
3	Parcela me numer 4 A	4,084.00	0.50	0.09	0.59	2,409.56
4	Parcela me numer 5 A	720.00	0.50	0.09	0.59	424.80
5	Parcela me numer 6 A	85.00	0.50	0.09	0.59	50.15
6	Parcela me numer 7 A	1,000.00	0.50	0.09	0.59	590.00
7	Parcela me numer 8 A	2,400.00	0.50	0.09	0.59	1,416.00
8	Parcela me numer 9 A	2,000.00	0.50	0.09	0.59	1,180.00

4. Njësia Biznisore Minerat me flotacion Kishnicë dhe Artanë

Emertimi i parcelës	Siperfaqja e mbuluar(m2)	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Total qeraja (€)	Siperfaqja e pa mbuluar(m2)	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Total qeraja (€)	Gjithsejt qeraja (€)
